VENDIM
Nr.1246, datë 23.12.2009

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA DREJTORIA RAJONALE RRUGORE, LEZHË, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e drejtorisë rajonale rrugore, Lezhë të përfundojë, brenda datës 31 dhjetor 2009, si autoritet kontraktor, procedurat e prokurimit për investime "Riveshje pjesore, Ura e Fanit-Autostradë" dhe "Riveshje pjesore, Kakarriq", me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2009, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse e publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Agjencia e Prokurimit Publik dhe drejtoria rajonale rrugore, Lezhë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi 1

NR.	***OBJEKTI I PROKURIMIT***	***AUTORITETI KONTRAKTOR***
1	*RIVESHJE PJESORE URA E FANIT-AUTOSTRADË*	*DREJTORIA RAJONALE RRUGORE,LEZHË*
2	*RIVESHJE PJESORE KAKARRIQ*	*DREJTORIA RAJONALE RRUGORE, LEZHË*